

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **215/33600-26-2947-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me radio lidhje për nevoja të SHKK-së**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>InterAdria L.L.C.</b>
NUI	<b>810819336</b>
Adresa	<b>ALI KELMENDI NR.28</b>
Vendi	<b>PRISHTINË</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>038246375</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>SHKUMBIN KAJTAZI</b>
Adresa elektronike	<b>interadria@interadria-ks.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>01.07.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Furnizim me radio lidhje për nevoja të SHKK-së**

**B05 Njoftim per Kontrat 06.05.2026 16:12**

**Kodi i dokumentit: 2026/215/33600-26-2947-1-1-1/B05-0008353**

**Dosjen e kemi shkarkuar me date 07.05.2026**

**Kerkese per sqarime shtese derguar me 05.06.2026**

**Pergjigje ndaj kerkeses per sqarime kemi pranuar me 10.06.2026**

**Kerkese per Rishqyrtim derguar me 12.06.2026**

**B54 Formulari standard per korrjgimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara  
16.06.2026 15:47**

**Kodi i dokumentit: 2026/215/33600-26-2947-1-1-1/B54-0012055**

**Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim Vendim.pdf19.06.2026 14:35**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Bazuar në ekzaminimin e bërë të specifikimeve teknike kemi vërejtur që AK nuk ka respektuar LPP-ne dhe si rrjedhojë kanë përpiluar specifikime teknike në kundërshtim me

Neni 1 - Qëllimi i aktivitetit

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 28 - Specifikimet teknike

Neni 19.6 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurimin Publik

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne si OE të cilet kemi shprehur interesim për të marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, në afatin ligjor të parapare me Ligjin për Prokurimin Publik, paraqitem këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, me të cilin kërkesa jonë për rishqyrtim është konsideruar si pjesërisht e bazuar.

Vendimi i AK-se është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren Nr. 01/2022 për Prokurimin Publik dhe parimet themelore që rregullojnë procedurat e prokurimit publik, pasi nuk përmban asnjë arsytim konkret lidhur me pretendimet tona, nuk analizon faktet e paraqitura dhe nuk mbështetet në asnjë provë apo analizë teknike.

AK nuk ka kundërshtuar asnjë nga argumentet tona me prova objektive, por as ka ofruar ndonjë ndryshim, prapë dosja e tenderit ka ngelur e njëjta me të vetmin ndryshim shtyrja e afatit të dorzimit të ofertes.

Në praktiken e konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit është theksuar vazhdimisht se një vendim administrativ duhet të jetë i arsytuar në aspektin faktik dhe juridik. Arsyetimi nuk është një formalitet procedural, por një element thelbësor që garanton transparencën, kontrollin e ligjshmerisë dhe ushtrimin efektiv të mjeteve juridike.

Në rastin konkret, vendimi i AK-se nuk u përgjigjet pretendimeve tona lidhur me karakterin diskriminues të specifikimeve teknike, mungesën e proporcionalitetit,

kufizimin e konkurrencës dhe referencën indirekte ndaj një produkti të vetëm në treg.

Per pasoje, vendimi i kontestuar është i paarsyetuar dhe si i tillë duhet të plotësohet apo i tërë procesi të anulohet dhe të rishpallet me ndryshimet e duhura.

Ligji për Prokurimin Publik mbështetet në parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, transparencës dhe konkurrencës efektive.

Keto parime nuk kanë karakter deklarativ, por janë norma detyruese që duhet të respektohen në çdo fazë të procedurës së prokurimit, përfshirë hartimin e specifikimeve teknike.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë nevojat e veta funksionale, mirëpo kjo e drejtë nuk është absolute.

Diskrecioni i AK-së kufizohet nga detyrimi që specifikimet teknike të mos kufizojnë konkurrencën me shumë sesa është e domosdoshme për realizimin e objektivit të kontratës.

Në LPP është theksuar në mënyrë konsistente se AK duhet të hartojë specifikime të bazuara në performancën dhe funksionin që kërkohej, e jo në karakteristika që përshkruajnë një zgjidhje teknike specifike ose një produkt të caktuar.

Në rastin konkret, AK nuk ka ndjekur këto standarde.

Perkundrazi, ka hartuar një kombinim specifikimesh teknike që nuk përshkruajnë rezultatin funksional të kërkuar, por arkitekturën teknike të një platforme konkrete.

Ky veprim ka prodhuar efektin e kufizimit të konkurrencës dhe eliminimit të shumicës së dërmuesve të operatorëve ekonomik nga pjesëmarrja në procedurë.

Neni 19.6 i Rregullores Nr. 01/2022 përcakton qartë se:

"Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik, burim, proces të vecantë, markë tregtare, patente, origjinë ose tip produkti është, si rregull i përgjithshëm, i ndaluar, përveç rasteve të vecanta kur një përshkrim i tillë është objektivisht i domosdoshëm dhe shoqërohet me shprehjen 'ose ekuivalente'."

Qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e konkurrencës dhe parandalimi i favorizimit të një operatori ose prodhuesi të caktuar.

Në rastin konkret, edhe pse emri "Kenwood Kairos KA-160" nuk përmendet në Dosjen e Tenderit, kombinimi kumulativ i specifikimeve teknike krijon një referencë de facto ndaj këtij produkti.

Praktika e prokurimit publik nuk ndalon vetem referencat e drejtperdrejta ndaj markave tregtare.

Po aq e ndaluar eshte edhe referenca indirekte, kur kombinimi i kerkesave teknike identifikon ne menyre unike nje produkt ose nje platforme te vetme ne treg.

Prandaj, nuk ka rendesi nese emri i prodhuesit nuk eshte shkruar ne dosje.

Rendesi ka efekti juridik dhe praktik i specifikimeve.

Nese rezultati eshte qe vetem nje produkt mund t'i plotesoje ato, atehere kemi te bejme me nje reference indirekte ndaj nje marke tregtare, ne kundershtim me nenin 19.6 te Rregullores Nr. 01/2022.

Ne procedurat e prokurimit publik nuk eshte detyre e operatorit ekonomik te vertetoje pse nje specifikim teknik nuk duhet te ekzistojte.

Perkundrazi, eshte detyrim ligjor i AK qe te deshmoje se cdo specifikim teknik eshte objektivisht i domosdoshem per realizimin e kontrates.

Kur nje operator ekonomik ngre pretendime se nje specifikim teknik kufizon konkurrencen, AK duhet te paraqese argumente teknike, analiza profesionale ose dokumentacion qe justifikon nevojën reale per secilen kerkese.

Ne kerkesen tone per rishqyrtim kemi kerkuar pikerisht nje arsyetim te tille.

Megjithate, AK nuk ka paraqitur asnje analize teknike, asnje studim te nevojave operative dhe asnje dokument qe te vertetoje domosdoshmerine e kombinimit te kerkesave te kontestuara.

Autoriteti Kontraktues ka percaktuar nje numer te konsiderueshem kerkesash teknike, te cilat, te analizuara vec e vec, mund te konsiderohen funksionalitete qe ekzistojne ne treg. Megjithate, problemi juridik dhe teknik nuk qendron tek secila kerkese individualisht, por tek kombinimi kumulativ i tyre. Praktika e prokurimit publik nuk e vlereson ligjshmerine e nje specifikimi duke analizuar secilen kerkese ne menyre te izoluar, por duke shqyrtuar efektin qe kombinimi i tyre prodhon mbi konkurrencen.

Ne rastin konkret, AK ka kerkuar qe repetitori te mbeshtese njekohesisht:

DMR Tier II, DMR Tier III, P25

TDMA dhe FDMA;

Receive Diversity;

RTP dhe SIP;

SNMP;

Multisite ne frekuence te njejte dhe frekuenca te ndryshme;

Cross-Band Linking;

Master/Slave;

Option Board;

FFSK dhe DSC;

Direct Mode;

si dhe karakteristika shume specifike RF dhe elektrike.

Edhe pse secila prej ketyre teknologjive ekziston ne treg, kombinimi i tyre ne nje pajisje te vetme redukton ne menyre drastike numrin e prodhuesve qe mund te marrin pjese ne procedure.

Analiza e kryer nga ekspertet teknik te kompanise sone si dhe te furnitoreve e mbeshtetur ne krahasimin e specifikimeve te me shume se pese prodhuesve te njohur nderkombetarisht (si psh. Hytera, Tait, Sepura, Motorola, Icom, Simoco), ka vertetuar se asnje prodhues nuk ofron nje pajisje te vetme qe i ploteson ne menyre kumulative te gjitha kerkesat e percaktuara nga AK.

Produktet alternative mund te realizojne shumicen e funksionaliteteve, mirepo jo ne nje platforme te vetme dhe jo me kombinimin identik te kerkesave te percaktuara ne Dosjen e Tenderit.

Nga kjo analize rezulton se vetem platforma Kenwood Kairos KA-160 i permbush ne menyre te plote te gjitha kerkesat e percaktuara.

Ky fakt tregon se Dosja e Tenderit nuk eshte hartuar mbi bazen e performances funksionale qe kerkohet nga institucioni, por mbi karakteristikat teknike te nje produkti konkret.

Ne kete menyre kufizohet konkurrenca reale dhe eliminohen operatoret ekonomik qe ofrojne zgjidhje funksionalisht ekuivalente.

Autoriteti Kontraktues mund te pretendoje se nuk ka permendur asnje marke tregtare ne Dosjen e Tenderit. Megjithate, kjo nuk e ben Dosjen ne perputhje me ligjin.

Ne praktiken e prokurimit publik pranohet se edhe kur emri i nje marke nuk permendet, kombinimi i karakteristikave teknike mund te krijoje nje reference indirekte ose de facto ndaj nje produkti konkret. Ne rastin konkret kemi pikerisht nje situatë te tille.

Pas analizimit te produkteve te Motorola, Hytera, Tait Communications, Sepura, Icom, Simoco dhe prodhuesve te tjere te njohur ne tregun nderkombetar, rezulton se asnje prej tyre nuk ofron nje pajisje qe permbush njekohesisht te gjitha kerkesat teknike te AK-se.

Ne shumicen e rasteve mungon nje ose me shume funksionalitete ose ato realizohen vetem permes pajisjeve shtese, moduleve apo servereve te vecante.

Per pasoje, efekti praktik i Dosjes se Tenderit eshte identifikimi i nje produkti te vetem ne treg.

Kjo eshte pikerisht ajo qe Ligji per Prokurimin Publik synon te parandaloje.

Ligji nuk ndalon vetem permendjen e emrit te prodhuesit, ai ndalon edhe hartimin e specifikimeve qe kane efektin praktik te favorizimit te nje prodhuesi te vetem.

Parimi i proporcionalitetit kerkon qe cdo kerkese teknike te jete e domosdoshme dhe ne raport te drejte me objektivin e kontrates. AK nuk ka paraqitur asnje dokument qe provon se secila prej kerkesave teknike eshte e domosdoshme. Po ashtu nuk ka paraqitur asnje analize qe verteton se qellimi i prokurimit nuk mund te arrihet me specifikime me fleksibile.

Ne vend te percaktimit te performances minimale qe duhet te arrije sistemi, AK ka percaktuar menyren se si duhet te ndertoht sistemi.

Kjo bie ne kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. Autoriteti Kontraktues ka te drejte te kerkoje rezultatin funksional.

Ai nuk ka te drejte te imponoje arkitekturen teknike te nje produkti te caktuar, nese ekzistojne zgjidhje alternative qe arrijne te njejtin rezultat.

Ne pozicionin "Radio Portative" AK ka kerkuar pajisje qe punojne sipas standardit DMR, asnje nga radiot e kerkuara nuk funksionon ne standardin P25.

Megjithate, per repetitorin kerkohet mbeshtetje njekohesisht per DMR Tier II, DMR Tier III dhe P25.

AK nuk ka dhene asnje arsyetim teknik pse sistemi duhet te mbeshtese nje teknologji qe nuk perdoret nga pajisjet fundore qe jane objekt i ketij prokurimi.

Ne mungese te nje justifikimi objektiv, kjo kerkese nuk lidhet me nevojat reale operative.

Perkundrazi, ajo zgjeron ne menyre artificiale kompleksitetin teknik te pajisjes dhe kufizon numrin e prodhuesve qe mund te ofrojne zgjidhje.

Ky eshte nje shembull tipik i nje kerkese joproporcionale qe cenon konkurrencen.

Po ashtu jane kerkuar funksionalitete si:

Receive Diversity; RTP; SIP; SNMP; Cross-Band Linking; Master/Slave; Multisite ne te njejten frekuence.

AK nuk ka paraqitur asnje analize qe deshmon se keto funksionalitete jane te domosdoshme per nevojat konkrete te ketij prokurimi.

Ne mungese te nje justifikimi teknik, ato nuk mund te konsiderohen kerkesa minimale.

Perkundrazi, ato paraqesin karakteristika te avancuara qe favorizojne nje numer shume te kufizuar produktesh. Ligji nuk e ndalon AK-ne te kerkoje teknologji moderne. Por kerkon qe ato te jene objektivisht te domosdoshme dhe jo thjesht karakteristika qe i posedon nje produkt i caktuar.

Ne Dosjen e Tenderit kerkohet qe repetitori te mbeshtese njekohesisht teknologjite TDMA dhe FDMA.

Edhe pse teknikisht kjo mund te realizohet nga disa platforma, AK nuk ka shpjeguar pse te dyja teknologjite jane te domosdoshme ne te njejten kohe.

Mungon analiza qe do te vertetonte nevojen operative per kete kombinim.

Per pasoje, edhe kjo kerkese mbetet e paarsyetuar dhe joproporcionale.

AK ka kerkuar qe repetitori te jete i zgjerueshem me Option Board dhe te mbeshtese modem FFSK dhe DSC.

Keto funksionalitete nuk lidhen me funksionimin baze te nje repetitori DMR dhe nuk jane shoqeruar me asnje arsyetim qe tregon se jane domosdoshmeri operative.

Ne mungese te nje analize te tille, keto kerkesa nuk mund te konsiderohen si kerkesa minimale teknike, por si elemente qe kufizojne pjesemarrjen e operatoreve ekonomik.

Prandaj edhe keto kerkesa bien ne kundersizim me parimin e proporcionalitetit dhe

konkurrenca efektive.

Ne Dosjen e Tenderit AK ka kerkuar qe repetitori te jete ne perputhshmeri minimale me standardet:

EN 300 086-2; EN 300 113-2; ETSI TS 102 361; EN 301489-1; EN 301489-5; EN 50385; EN 60065/A1;

FCC; IC RSS-119.

Ndersa standardet EN dhe ETSI perbejne standardet relevante per tregun evropian, standardet FCC (Federal Communications Commission) dhe IC RSS (Innovation, Science and Economic Development Canada) jane standarde kombetare qe aplikohen ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes dhe Kanada.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnje arsytim teknik apo ligjor pse nje produkt qe do te perdoret ne Republiken e Kosoves duhet domosdoshmerisht te certifikohet edhe sipas standardeve amerikane dhe kanadeze.

Ne mungese te nje arsytimi te tille, kjo kerkese nuk lidhet me objektin e kontrates dhe nuk ndikon ne funksionalitetin e pajisjes ne territorin ku ajo do te perdoret.

Perkundrazi, kerkesa e tille redukton ne menyre te panevojshme numrin e prodhuesve qe mund te konkurrojne, pasi ekzistojne pajisje qe jane plotesisht ne perputhje me standardet evropiane, por nuk posedojne certifikime FCC ose IC RSS per shkak se nuk jane destinuar per tregun e Amerikes Veriore.

Ne praktiken e prokurimit publik specifikimet teknike duhet te lidhen drejtperdrejt me nevojat reale te kontrates dhe nuk mund te vendosen kerkesa qe nuk ndikojne ne performancen ose sigurine e produktit ne vendin ku ai do te perdoret.

Per rrjedhoje, kerkesa per standardet FCC dhe IC RSS eshte joproportionale dhe kufizuese.

AK ka kerkuar qe repetitori te mbeshtese modalitetin analog dhe sinjalizimet:

EEA; EIA; CCIR; DTMF; ZVEI 1; ZVEI 2.

Keto teknologji jane zhvilluar dekada me pare dhe perdoren kryesisht ne sisteme analoge tradicionale. Objekti i ketij prokurimi eshte furnizimi me pajisje DMR, ndersa radiot portative te kerkuara jane pajisje dixhitale.

AK nuk ka dhene asnje arsytim pse nje infrastrukture moderne DMR duhet domosdoshmerisht te mbeshtese nje numer kaq te madh sinjalizimesh analoge.

Per me teper, keto sinjalizime nuk ofrojne nivelin e sigurise dhe funksionalitetit qe ofrojne sistemet moderne dixhitale. Per nje institucion te sigurise, si ShKK, perdorimi i teknologjive analoge nuk paraqet avantazh operacional, por perkundrazi ul nivelin e

sigurise se komunikimit.

Ne mungese te nje analize qe verteton domosdoshmerine operative te ketyre funksionaliteteve, kerkesa rezulton joproporcionale dhe kufizuese.

AK ka kerkuar qe ofertuesit te paraqesin autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar per paisjet kryesore. Kjo kerkese nuk eshte shoqeruar me asnje arsytim objektiv.

Pajisjet per te cilat kerkohet autorizimi perbejne nje pjese shume te vogel te vleres totale te kontrates, me pak se 5%.

Ne keto rrethana, kerkesa per autorizim nuk eshte ne raport te drejte me objektin dhe vleren e kontrates.

Qellimi i procedures se prokurimit publik eshte sigurimi i konkurrences sa me te gjere.

Vendosja e kerkeseve qe kufizojne pjesemarrjen duhet te justifikohet me rrethana konkrete dhe objektive.

Ne rastin konkret nuk ekziston asnje argument qe tregon se realizimi i kontrates do te vihej ne rrezik ne mungese te autorizimit nga prodhuesi.

Perkundrazi, kjo kerkese favorizon operatoret qe gezojne marredhenie ekskluzive me prodhuesin dhe kufizon ne menyre artificiale pjesemarrjen e operatoreve te tjere ekonomik.

OSHP ne vendimet e saj ka vleresuar ne menyre te perseritur se kerkesat per autorizim duhet te jene te arsyetuara, proporcionale dhe te lidhura drejtperdrejt me objektin e kontrates. Ne mungese te nje arsytimi te tille, ato mund te krijojne pengesa te pajustificuara per konkurrencen.

Ne kerkesen tone per rishqyrtim kemi paraqitur argumente konkrete juridike dhe teknike.

Kemi identifikuar dispozitat e Ligjit per Prokurimin Publik qe konsiderojme te shkelura.

Kemi paraqitur analiza teknike.

Kemi argumentuar efektin kufizues te specifikimeve.

Kemi kerkuar qe AK te justifikojte secilen kerkese teknike.

Megjithate, vendimi i dates 19.06.2026 nuk trajton asnje nga keto pretendime.

AK nuk ka shpjeguar:

pse kerkohet mbeshtetja e P25;

pse kerkohet kombinimi i DMR Tier II, DMR Tier III dhe P25;

pse jane te domosdoshme Receive Diversity, RTP, SIP, SNMP dhe Cross-Band Linking;

pse kerkohen standardet FCC dhe IC RSS;

pse kerkohen sinjalizimet analoge;

pse kerkesa per autorizim konsiderohet proporcionale.

Ne vend te nje analize individuale te secilit pretendim, AK ka nxjerre nje vendim formal pa administruar asnje prove dhe pa paraqitur asnje arsyetim teknik.

Nje vendim i tille nuk i permbush standardet minimale te nje akti administrativ te ligjshem.

Mosarsyetimi i vendimit cenon te drejten e operatorit ekonomik per nje mjet juridik efektiv, pasi e ben te pamundur kontrollin e ligjshmerise se vendimmarrjes se AK-se.

Nga te gjitha faktet dhe provat e paraqitura rezulton se:

AK ka hartuar specifikime teknike qe krijojne reference indirekte ndaj nje produkti te vetem ne treg;

nuk ka arsyetuar objektivisht domosdoshmerine e tyre;

nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit;

ka kufizuar konkurrencen ne kundertshtim me Ligjin per Prokurimin Publik;

ka kerkuar standarde qe nuk lidhen me nevojat reale te kontrates;

ka vendosur kerkesa qe nuk jane te domosdoshme per realizimin e objektit te kontrates;

Efekti praktik i Dosjes se Tenderit eshte qe vetem nje produkt ne treg mund te plotesoje ne menyre kumulative te gjitha specifikimet teknike.

Ky rezultat bie ndesh me qellimin e Ligjit per Prokurimin Publik, i cili synon garantimin e konkurrences efektive, trajtimit te barabarte dhe perdorimit efikas te fondeve publike.

Duke u bazuar ne Ligjin per Prokurimin Publik, Rregulloren Nr. 01/2022 dhe faktet e

paraqitura ne kete ankese, propozojme qe Organi Shqyrtues i Prokurimit:

Ta aprovoje ankesen si te bazuar.

Ta urdheroje Autoritetin Kontraktues qe te beje korrigjimin e Dosjes se Tenderit, duke eliminuar specifikimet teknike qe kufizojne konkurrencen dhe krijojne reference de facto ndaj nje produkti te vetem.

Ta urdheroje AK-ne qe specifikimet teknike te hartohen mbi bazen e performances dhe funksionalitetit, ne perputhje me nenin 19.6 te Rregullores Nr. 01/2022 dhe parimet themelore te Ligjit per Prokurimin Publik.

Ta urdheroje AK-ne te largoje kerkesat qe nuk jane objektivist te justifikuar, pefshire:

mbeshtetjen e teknologjise P25;

standardet FCC dhe IC RSS;

kerkesat e panevojshme per sinjalizimet analoge;

kerkesen per autorizim nga prodhuesi ose distributori, ne mungese te nje arsytimi objektiv dhe proporcional.

Ta detyroje AK-ne qe, ne rast te ruajtjes se ndonje kerkese teknike te kontestuar, te paraqese arsyetim teknik dhe funksional te dokumentuar qe verteton domosdoshmerine e saj ne raport me objektin e kontrates dhe nevojat reale operative.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

N/A

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*